REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE**

Nr.2438/1 prot. Himarë, më 17.03.2025

**PROJEKTVENDIM**

**Nr. 12 datë, 17.03.2025**

**Për një ndryshim në vendimin nr. 28 datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë"**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", nenit 28, të ligjit nr. 89/2022 "Për policinë bashkiake", vendimit nr. 328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar me VKM nr. 503, datë 01.08.2024, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar me VKM nr. 422, datë 26.06.2024, vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar me VKM nr. 421, datë 26.06.2024, vendimit nr. 39, datë 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak Himarë "Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë"

**VENDOSI:**

1. Te vendimi nr. 28, datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë", pas lidhjes nr. 10, të shtohet lidhja nr. 11 me titull "Niveli i pagave për punonjësit e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë", bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë.

3. Ndryshimet e këtij vendimi të pasqyrohen në vendimin nr. 39, datë 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak Himarë "Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë"
4. Ngarkohen *drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, drejtoria e zhvillimit ekonomik, ndërmarrja e shërbimeve publike,* për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i dryshuar.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

Drejtor i DZHE
Laert Mezani

Drejtor i DBNJISHD
Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE
Ardit Muhametaj

**Lidhja nr. 11 – Niveli i pagave për punonjësit e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë.**

## a) Punonjësit e administratës:

| Klasa | Emërtesat e pozicioneve të punës | Grupi i diplomës | Paga për pozicion |
|---|---|---|---|
| II-2 | Drejtor i ndërmarrjes | 1 | 141.000 |
| III-2 | Përgjegjës sektori | 1 ose 2 ose 3 | 105.000 |
| IV-3 | Specialist | 1 ose 2 ose 3 | 70.000 |
| | Punonjës administrativ (Arsim i mesëm) | | 47.000 |

**Punonjësit e administratës, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:**

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, "vite pune" do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, si dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

## b) Punonjësit mbështetës:

| Emërtesat e pozicioneve të punës | Klasa | Vjetërsia | Paga bazë | Shtesa për natyrë të veçantë pune |
|---|---|---|---|---|
| Manovrator | XIII | 1% | 46.700 | 4.000 |
| Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme | V | 1% | 42.800 | 4.000 |
| Elektricist | V | 1% | 42.800 | 4.000 |
| Hidraulik | V | 1% | 42.800 | 4.000 |
| Magazinier | IV | 1% | 42.500 | 4.000 |
| Shofer | III | 1% | 41.800 | 4.000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme | III | 1% | 41.800 | 4.000 |
| Punëtor mirëmbajtjeje | III | 1% | 41.800 | 4.000 |
| Punëtor pastrimi/Sanitar | I | 1% | 40.000 | 4.000 |
| Roje objektesh | I | 1% | 40.000 | 4.000 |

**Shënim:** Shtesa për natyrë të veçantë pune është caktuar në zbatim të gërmës *m*, të pikës 1, të VKM-së nr. 422, datë 26.06.2024 "Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar.

Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, "vite pune" do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Përjashtohen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

Drejtor i DZHE
Laert Mezani

Drejtor i DBNJISHD
Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE
Ardit Muhametaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA HIMARË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE**

Nr. 2438/2 prot. Himarë, më 17.03.2025

# RELACION

## PËR PROJEKTVENDIMIN

**Për një ndryshim në vendimin nr. 28 datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë"**

## KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Bazuar në pikën 2, të nenit 8, pikën 1.1.b, të nenit 9, pikën ç, të nenit 54, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë si më poshtë:

Me anë të vendimit nr. 39, datë 20.12.2024 të Këshillit Bashkiak Himarë "Për krijimin e ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë si institucion varësie të Bashkisë Himarë", është miratuar krijimi i ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë, më pas janë bërë procedurat administrative përkatëse për krijimin dhe funksionimin e ndërmarrjes, gjithashtu me anë të vendimit nr. 1, datë 22.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Himarë "*Për miratimin e strukturës së ndërmarrjes së shërbimeve publike Himarë për vitin 2025*", është miratuar edhe struktura e ndërmarrjes.

Pas këtyre veprimeve lind nevoja që të bëhet edhe një ndryshim në vendimin nr. 28 datë 29.08.2024 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë", duke shtuar edhe një lidhje te ky vendim, ku të përfshihen edhe pagat e ndërmarrjes së shërbimeve publike. Konkretish pas lidhjes nr. 10 të vendimin nr. 28 datë 29.08.2024 , do të shtohet lidhja nr. 11, ku përfshihen pagat për punonjesit e ndërmarrjes së shërbimeve publike, tek pika *a* janë pasqyruar pagat për punonjësit e administratës dhe tek pika *b* pagat për punonjësit mbështetës.

Për sa ju parashtruam në këtë relacion, bazuar në kërkesat e pikës "ç", të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe nenit 9, të ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi, nga ana e Këshillit Bashkiak.

**KRYETARI I BASHKISË**

**Vangjel Tavo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA HIMARË

Drejtor i DZHE
Laert Mezani

Drejtor i DBNJISHD
Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE
Ardit Muhametaj

Proçesverbali i mbledhjes së komisionit të përhershëm të këshillit

**Data** 28.03.2025.

**Ora e hapjes së mbledhje** 13:30.

Marrin pjesë : 1. Gjergji Iliadhi këshilltar- kryetar i komisionit

2. Miltiadh Priftti këshilltar – nënkryetar komisioni

3. Loreta Jani sekretar i komisionit

4. Anëtar Silva Burbo

5. Anëtar Maks Vlashi

6. Anëtar

7. Anëtar

Marrin pjesë gjithashtu : Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Elisabeta Lamaj
2. Werkila Husi
3.

Nga ekzekutivi marrin pjesë : drejtoria juridike, drejtoria financës dhe drejtoria e burimeve njerezore.

Kryesuesi i mbledhjes është Z/Zj Gjergji Iliadhi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes **deklaroi kuorumin** prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i **konfliktit të interesit:**

**Pika 1 e rendit të ditës.**

*Projektvendim* " Për një ndryshim ne vendimin nr. 28, date 29.08.2024 të Keshillit Bashkiak " Për miratimine nivelit te pagave te punonjesve te Bashkise Himare. *propozuar nga*

Drejtuesi i komisionit prezanton projektvendimin anetareve te komisionit

**Pyetje** ( nga këshilltarët ) Pse nuk u ndryshua niveli pagave per keta punonjes si gjithe punonjesit e administrates?

**Përgjigje** / sqarime nga ekzekutivi Sepse kjo ndermarrje kaloje ne varesi me vete me propozim te kryetarit te Bashkise dhe me vendimin tuaj me muajin gush te vitit 2024.

**Diskutime** :

Këshilltari Gjergji Iliadhi deklaroi / propozoi të kalojë materiali në këshill për shqyrtim

Këshilltari Miltiadh Prifti deklaroi / propozoi të kalojë në këshill.

Këshilltari Loreta Isefi deklaroi / propozoi të kalojë për shqyrtim
Silva Bierbo propozoi, po. të kalojë në shqyrtim.

Hidhen në votë propozimet për amendim të projektvendimit :

Propozim 1 : Vota PRO 4 Kundra ______ Abstenim ______ Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 2 : Vota PRO 4 Kundra ______ Abstenim ______ Miratohet / Nuk miratohet

Miratohet materiali për t'u shqyrtuar në këshill.

Propozim 3 : Vota PRO _____ Kundra ______Abstenim _______Miratohet / Nuk miratohet

**Pika 2 e rendit të ditës.**

***Projektvendim " ________" propozuar nga ___________***

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimin

**Pyetje** ( nga këshilltarët ) ______________________________________________

**Përgjigje** / sqarime nga ekzekutivi ______________________________________

**Diskutime** :

Këshilltari ______________________deklaroi / propozoi______________________________________

Këshilltari ______________________deklaroi / propozoi______________________________________

Këshilltari ______________________deklaroi / propozoi______________________________________

**Hidhen në votë** propozimet për amendim të projekt-vendimit :

Propozim 1 : Vota PRO ____ Kundra _______Abstenim _______Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 2 : Vota PRO ____ Kundra _______Abstenim _______Miratohet / Nuk miratohet
Propozim 3 : Vota PRO _____ Kundra ______Abstenim _______Miratohet / Nuk miratohet

**Mbyllet diskutimi**

**Përgatitet Raporti** i mbledhjes së Komisionit për çdo projekt-vendim që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Raporti u përgatit nga Kryetari / zëvendëskryetari i Komisionit/ sekretari i Komisionit

**Lexohet Raporti** (1, 2) nga Kryetari / zëvendëskryetari (për çdo projekt-vendim)

**Votohet Raporti** (1, 2 ) : Votimi u bë i hapur/ fshehtë – (për çdo projekt-vendim)

**U votua raporti** Projektvendim nr.____ ,PRO ___________KUNDER _______ABSTENIM _- Miratohet / Nuk miratohet

**U votua raporti** Projektvendim nr.____, PRO ___________KUNDER _______ABSTENIM _- Miratohet / Nuk miratohet

**Mbyllet mbledhja e Komisionit**

Ora e mbylljes së mbledhjes ____________________________

Nënshkruhet proçesverbali i mbledhjes së komisionit

**Kryetari i Komisionit**

Gjergji Iliadhi

Silva . B

Loreta . J.

Maks . V.

Zëvendësekretar

**Sekretari i Komisionit**

Miltiadh Prifti

Komisioni Ekonomisë, financës, auditit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KOMISIONI I PËRHERSHËM I ~~ZHVILLIMIT URBAN, INFRASTRUKTURES DHE SHERBIMEVE PUBLIKE~~
KËSHILLIT BASHKIAK

**Raporti i vendimmarrjes së komisionit të përherëshëm**

(Adresa, 25 Marsi, Spile Himarë. Tel________, e-mail www.Himara.gov.al.)

**Komisoni i Përhershëm për "** ~~Zhvillimit urban, infrastrukturës dhe shërbimeve publike~~

**RAPORT VENDIMMARRJE**

Nr 2438/1 Prot

Nr. 2438/1 Datë: ___.___.2024

Nr: 12. date 17.03.2025

*Drejtuar:* Këshillit të Bashkisë

*Lenda:* Vendim për shqyrtimin e projekvendimit nr 12 datë 17.3.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "miratimin e nivelit te pagave te punonjesve te Bashkise Himare

**Analiza ligjore**: (bazueshmëria ligjore) Bazuar ne ligjin e vetëqeverisjes vendore 139/2015, neni 54 i ketij ligji

**Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit) ky vendim eshte me sherbim te punonjesve te administrates te B. Himare

**Situata financiare :** (Shtesa / pakësime në buxhet) Shtesa ne paga te punonjesve të nje ndermarrje ne vartesi te Bashkise

**Drejtoria / Sektori përgjegjës** Drejtoria e Burimeve Njerezore, informacionit dhe sherbimeve digjitale.

**Monitorimi dhe raportimi :** (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh) Raporton drejtoria përkatëse Z. Andon Cani, Z. Laert Merani

**Impakti social / grupet që preken:** Impakt, punonjesit e Bashkise

**A është objekt i konsultimit publik:** Jo.

Komisioni i Përhershëm për "ekonominë, financën dhe auditin", i mbledhur me datën 28.03.2025 shqyrtoi projekt vendimit nr.12 datë 17.03.2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "miratim" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë. miratim për nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni

me shumicë votash,

**VENDOSI;**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim

b) miratimin e projektaktit

c) refuzimin e miratimit të projektaktit

d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:

✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në "-------------------------- "

✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në " ------------------------- "

✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në " --------------------------"

✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në " --------------------------"

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Gjergji Iliadhi ________ **Kryetar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*
Miltiadh Prifti ________ Nënkryetar **Sekretar i Komisionit**
*(emri, mbiemri, firma)*

Silva Borbo
Loreta Isufi
Marks Vlashi

Datë 28.03.2025